

VENDIM
Nr.828, datë 13.10.2010

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1282, DATË 23.12.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTËN E PRANIMIT DHE TARIFËN E SHKOLLIMIT NË
PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË, TË STUDIMEVE SPECIALIZUESE
AFATGJATA, NË FAKULTETIN E MJEKËSISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS,
PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.2, 34, 35 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2 të vendimit nr.1282, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave, shtohen pikat 2.1 dhe 2.2, me këtë përmbajtje:

“2.1. Kuota për transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme, për kandidatët nga brenda dhe jashtë vendit, është 5.

2.2. Modalitetet e transferimit të studimeve realizohen nga institucioni i arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e tij.”.

2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha